

Ne fokus/ Valmir Berisha shume larg Shqiperise

nga AlbaniaSoccer

E martë, 03 Dhjetor 2013 20:31



Valmir Berisha ka zgjedhur te luaje me Suedine, por nje sulmues me nuhatje te theksuar per golin do t'i bente shume pune kombetares shqiptare. FSHF ende nuk i ka bere nje oferte zyrtare lojtarit 17 vjecar por duket se kjo lidhje ka veshtiresi te shumta per tu bere. Berisha pret te transferohe nga Suedia ne nje klub te madh ne muajin janar dhe duke bere kete ai do te deshiroj nje kombetare te madhe si ajo suedeze. Burime jo zyrtare prane FSHF-se thone se Berisha nuk do te perzihet fare ne bisedime me Shqiperine. Gjithsesi, duke qene se tifozet kerkojne qe te behet maksimumi per ta afruar ate ne perfaqesuesen tone, FSHF duket se nuk do ta humbase rastin por do te tentoje ta binde sulmuesin te veshe fanellen e Kombetares Kuqezit. Veshtiresite jane te medha dhe per momentin Berisha eshte shume larg Shqiperise.